



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

**Lënda: ZHANRET MEDIATIKE**

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Jonila GODOLE
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 1 leksion dhe 1 seminar në javë )
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyruar
<i>Viti/semestri:</i>	II/III

**Përshkrimi:** Lënda është konceptuar si një *hyrje në praktikën e gazetarisë* ku synohet të transmetohen njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të shkruar në mënyrë të pavarur format e ndryshme të pasqyrimin publicistik (zhanret gazetareske). Zhanret radiofonike dhe televizive vetëm sa do të preken dhe nuk do të shpjegohen hollësisht, meqë nuk janë pjesa kryesore e kësaj lënde. A dallojnë zhanret në gazetatat „ e specializuara“ nga ato të gazetarisë klasike? Në thelb të raportimit profesional qëndrojnë rregullat bazë të ndarjes së informacionit nga opinioni, si dhe te pjeses redaksionale nga reklama.

**Temat e leksioneve:**

1. Hyrje. Gazetaria dhe funksioni i saj - Roli i gazetarëve ; gazetaria « junk »; përse nevojiten gazetarë më të mirë, dhe si t'i dallojmë ata
2. Gazetaria në Shqipëri dhe tipologjia e gazetarëve - Specifikat e gazetarisë në vend, zhvillimi i saj dhe qasjet e gazetarëve ndaj profesionit, zhanreve etj.
3. Gjuha e gazetarisë dhe rëndësia e fjalës - Cilësia e gazetarisë përmes fjalës, sinonimeve, tekstit, mendimit, llojit të zhanreve
4. Zhanret Informuese - Lajmi si kategori e informacionit publik; njoftimi, kronika. Format e lajmit dhe mënyra e ndërtimit të tij. Analiza konkrete të lajmeve të botuara dhe transmetuara, matja e vlerës lajmore
5. Zhanret informuese: Intervista – Roli i intervistës gazetareske dhe teknikat e saj. Si bëhet një intervistë, nga parapërgatitja deri te përfundimi i saj. Analiza konkrete të intervistave të botuara dhe transmetuara
6. Llojet e pyetjeve në intervistën gazetareske - Përveç pyetjeve të hapura dhe të mbyllura ka një sërë pyetjesh të tjera që gazetaret përdorin për të marrë informacion
7. Reportazhi, portreti dhe stili publicistik – Si shkruhet dhe si analizohet një reportazh, llojet e reportazhit, historiku i zhvillimit të tij. Përshatja e reportazhit për gazetarinë online dhe webin sot.
8. Feature vs. Reportazh - Dallimi dhe ngjashmëritë mes dy zhanreve të ngjashme. Feature si zëvendësues i reportazhit gjen përhapje të madhe sot në median ndërkombëtare duke qenë se shkrin lajmin me reportazhin dhe ofron më shumë mundësi shprehjeje.
9. Zhanret Analitike (I) Komenti dhe Editoriali – njohja dhe analiza e zhanreve analitike, karakteristikat dhe mënyra e përdorimit. Llohet e komenteve dhe ndërtimi i tyre. Analiza konkrete e komenteve të botuara në web, shtypin e shkruar.
10. Zhanret Analitike (II) – Njohja dhe analiza me grupin e zhanreve: Fejtoni, kritika, pamfleti etj.
11. Zhanret në gazetarinë online - Kriteret e klasifikimit të zhanreve online ; hipertekstualiteti, multimedialiteti, interaktiviteti, temporaliteti etj.

12. Tiparet e gazetarisë në epokën e Crossmedia-s - Media të reja, rregulla të vjetra. Nuk ka medime të reja, por vetëm forma të reja për të përçuar përmbajtjen. Interneti dhe ndikimi në gazetari dhe zhanret e saj. Në thelb të gazetarisë qëndron titulli kryesor (joshja e audiencës me diçka të fortë) teksti dhe figura.
13. Të shkruash për PR (marrëdhëniet publike) - Formulimi i Newsletter, njoftimet për shtyp etj.
14. Gazetaria Qytetare (Sociale) dhe format e saj paraqitëse
15. Formate të specializuara - Gazetaria investigative dhe ajo bulevardeske

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	20% e notës
- Detyra e kursit / ose ese:rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. Ruß-Mohl, S, *Gazetaria*, K&B, Tiranë 2011.
2. Bill Kovach & Tom Rosenstiel (2011). *Elementët e gazetarisë*. (Kapitulli 7-8). ISHM. Tiranë
3. Bill Kovach & Tom Rosenstiel (2012). *Flu. Si të njohësh të vërtetën në epokën e mbingarkesës së informacionit*. ISHM. Tiranë (Kapitujt 3, 5)
4. B.S. Brooks, G. Kennedy, D.R. Moen, D. Ranly (2012). *Raportimi dhe shkrimi i lajmeve*. IDK. Tiranë (kapitulli 3, fq. 43-55)
5. Boriçi, Hamit (2002). *Gazetaria 2: Probleme të mjeshtrisë dhe format e pasqyrit publicistik*, ISHM, Tiranë

#### **Literatura plotësuese:**

1. Fedler, F. *Reporting for the media*, Oxford University Press 2005
2. Palacios, Marcos/Noci D. Javier. *Online journalism research. A multidisciplinary approach in comparative perspective*. Universidad del Pais Vasco. (Chapter 2. 21-38) 2007.
3. Baxhaku, F. *Gur. Përmbledhje me reportazhe*, Papirus 2008
4. Böll, H. *Nderi i humbur i Katherina Blum*, Tiranë 2006